

VENDIM
Nr. 494, datë 13.9.2017

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT SHTETËROR PËR ORGANIZIMIN E
VEPRIMTARIVE, NË KUADËR TË “VITIT MBARËKOMBËTAR TË GJERGJ
KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nën kujdesin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe të Presidentit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit Shtetëror për organizimin e veprimtarive, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”.

2. Ky Komision të kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- a) Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- b) Ministrin e Mbrojtjes;
- c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- ç) Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- d) Ministrin e Kulturës;
- dh) Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- e) Ministrin e Shtetit për Diasporën;
- ë) Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave;
- f) Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- g) Drejtorin e Përgjithshëm të Arkivave;
- gj) Drejtorin e Muzeut Kombëtar;
- h) Drejtorin e Bibliotekës Kombëtare;
- i) Drejtorin e Përgjithshëm të Institutit të Monumenteve të Kulturës;
- j) Përfaqësuesin e kabinetit të Kryeministrit.

3. Me ftesë të kryetarit dhe me pëlqimin paraprak të tyre në këtë Komision ftohen të marrin pjesë:

- përfaqësues të kabineteve të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe të Presidentit të Republikës së Kosovës;

- Kryetari i Kuvendit dhe zëvendëskryetarët;
- kryetarët e komisioneve parlamentare për çështjet e ekonomisë dhe të integritetit evropian;
- përfaqësues të kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- përfaqësues të bashkive të Tiranës, Prishtinës, Tetovës dhe Ulqinit;
- përfaqësues të Akademisë së Shkencave;
- personalitete dhe figura të shquara, akademikë, historianë, njohës të artit dhe kulturës, si dhe përfaqësues të institucioneve e të shoqërisë civile;

- përfaqësues të komunitetit të shqiptarëve të Malit të Zi dhe arbëreshëve të Italisë.

4. Komisioni të marrë të gjitha masat për hartimin dhe miratimin e planit të veprimit e të kalendarit të festimeve, si dhe të përcaktojë llojet e veprimtarive, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”.

5. Komisioni mblidhet me kërkesë të kryetarit dhe sa herë që shihet e nevojshme.

6. Komisioni Shtetëror do të ndihmohet nga sekretariati teknik, i cili ka këto detyra kryesore:

- a) përgatit takimet e Komisionit;
- b) raporton periodikisht pranë Komisionit për realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme të tij;
- c) bashkërendon punën ndërmjet institucioneve të përfshira për zbatimin dhe monitorimin e detyrave

të lëna prej Komisionit;

ç) mban procesverbalet dhe harton vendimet e marra nga Komisioni;

d) kryen detyra të tjera që përcaktohen nga kryetari i Komisionit.

7. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe detyrat e hollësishme të sekretariatit teknik përcaktohen me vendim të Komisionit.

8. Ngarkohen të gjithë anëtarët e Komisionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama